



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Adresa : Rruga Durrësit, Laprakë, Tiranë

Tel: 04 2256-547

**Nr. 12403/1 Prot**

**Tiranë, më 06 /09 /2012**

**U D H E Z I M**

**Nr. 01, datë 06. 09. 2012**

**Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv**

Në zbatim të Ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” Pjesa IV e tij - Destinacioni Doganor, Kreu 2 - Regjimet Doganore, Seksioni 3 - Regjimet pezulluese dhe regjimet doganore ekonomike Neni 107 - 112 dhe gërma D - Përpunimi Aktiv - Neni 136 -149, si dhe pikat 234 – 239, 272-325 dhe 463 - 472 të Dispozitave Zbatuese të Vendimit të Këshilli të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, në lidhje më regjimin e Përpunimit Aktiv;

Më qëllim, përcaktimin e saktë të procedurave doganore që zbatohen për miratimin, mbikëqyrjen dhe përmbylljen e regjimit doganor ekonomik të Përpunimit Aktiv, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave udhëzon:


**Neni 1**

**Konceptet kryesore**

1. Përpunimi aktiv është një regjim doganor ekonomik që në thelb ka si qëllim kryesor eksportimin e punës, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë ekonomike që në mënyrë direkte bëjnë transformim të thjeshtë apo përfundimtar në mallra të gatshëm, për t’u përdorur si produkte në operacione të tjera përpunimi, montimi, apo për konsum.
2. Regjimi i përpunimit aktiv lejon përpunimin e mallrave jo shqiptare të destinuara për t’u riekportuar në formën e produkteve kompensuese, pa pagesën e detyrimeve doganore ose më rimbursimin e tyre pas ri-eksportimit.
3. Në këtë përpunim emërtime shumë të rëndësishme janë:
  - *Mallrat për përpunim* – janë të gjitha mallrat jo shqiptare të cilat autorizohen të pezullohen nga detyrimet e importit.
  - *Operacionet e përpunimit* – janë të gjitha proceset që kryhen mbi mallrat.
  - *Koeficienti i shfrytëzimit* - sasia ose përqindja e produkteve kompensuese të përfuara nga përpunimi i një sasia të caktuar mallrash të importuara.
  - *Produkte kompensuese kryesore* – janë të gjitha mallrat të përfuara nga përpunimi dhe janë të gatshme për riekport.

- *Produkte kompensuese dytësore* - janë të gjitha mallrat jo shqiptare të mbetura pas operacioneve të përpunimit.
- *Koha e riekportimit* - është koha e parashikuar për kryerjen e operacioneve të përpunimit dhe të deklarimit për riekport të produkteve kompensuese
- *“Humbje(firo)”* do të thotë: pjesa e mallrave të importuara të cilat shkatërrohen dhe humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, çlirimit në trajtë gazi ose nga shpëlarja.

4. Në këtë këndvështrim skema e thjeshtë e qarkullimit të mallrave nën këtë regjim është:



5. Nën regjimin e përpunimit aktiv:

- Pronar i mallrave jo shqiptare është një shoqëri e huaj, të gjitha operacionet e përpunimit bëhen për llogari të saj dhe të gjitha produkteve kompensuese parësore i jepet destinacion rieksporiti drejt saj apo klientëve të saj; ose
- Pronar i mallrave jo shqiptare është një shoqëri shqiptare e cila kryen operacionet e përpunimit për llogarinë e vet dhe i rieksporiton produktet kompensuese parësore drejt klientë të saj të kontraktuar.

6. Sistemet e autorizuara:

- Sistem me Pezullim: Pezullim nga të gjitha detyrimet e importit për mallrat e futura në regjim. Autorizohet në rastet kur të gjithë produktet kompensuese parësore janë të destinuara për riekспорт dhe dihet paraprakisht destinacioni i rieksporitit.
- Sistem me rimbursim: Detyrimet Doganore paguhen paraprakisht e rimbursohen në momentin e rieksporimit. Aplikohet në rastet kur një pjesë e produkteve kompensuese parësore janë të destinuara për tu hedhur në qarkullim të lirë ose nuk dihet destinacioni i rieksporitit të produkteve kompensuese parësore.

## Neni 2

### Procedurat e përfitimit të regjimit të përpunimit aktiv

1. Në të gjitha rastet lëshimi i një autorizimi përpunimi aktiv mbështetet në parimin e vetë deklarimit. Vetë deklarimi bëhet në formën e kërkesës së plotë dhe të saktë sipas Aneksit 27 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor.

Kushtet themelore të pranimit të kërkesës dhe aprovimit të autorizimit janë:

- *Plotësimi i faktorit ekonomik* gjatë kryerjes së operacioneve përpunuese, që nënkupton rritjen e vlerës së mallrave të përpunuara në atë masë që justifikon kostot e prodhimit dhe fitimin e shoqërisë.
- *Identifikimi i mallrave të importuara për përpunim* në produktin kompensues, për të cilën përdoren metodat e mëposhtme :
  - tregimin ose përshkrimin e markave të veçanta ose numrave të fabrikimit;
  - marrje mostrash, ilustrime, ose përshkrime teknike;
  - kryerje analizash;
  - shqyrtimin e regjistrave të magazinimit ose dokumente të tjerë mbështetës lidhur me transaksionin në fjalë, të cilët tregojnë qartë që produktet kompensuese janë prodhuar nga mallrat e importit.

2. Kërkesa për përfitimin e regjimit të Përpunimit Aktiv bëhet duke plotësuar Aneksin 27 të Dispozitave Zbatuese dhe dorëzohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

- Kërkesa duhet të përmbajë bashkangjitur dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Dokumentacioni ligjor i shoqërisë
  - Kontrata porosie të shoqërisë me firmat e huaja, për përpunimin e mallrave.
  - Deklarim të shoqërisë në lidhje me efektet ekonomike që do të sjelle përdorimi i autorizimit. Në rastet kur importohen mallra të cilat për natyrën e tyre apo procesin teknologjik që kryhet humbasin pjesërisht apo tërësisht paraqitet karta teknologjike dhe metoda që ndiqet për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit.
  - Në rastet kur parashikohet të ketë një ose disa operatore paraqitet marrëveshja apo marrëveshjet mes operatorëve dhe kërkuesit të autorizimit si dhe identiteti fiskal i operatorit, deklaratë e operatorit mbi vendndodhjen e ambientit ku do

- kryhet përpunimi dhe disponibiliteti i tij për kontroll në çdo kohë nga organi doganor.
  - Rastet kur, kërkohet që zyrat doganore të hyrjes, mbikëqyrjes dhe mbylljes së regjimit të jenë të ndryshme, një deklaram të shoqërisë për argumentimin e saktë ekonomik.
  - Dokumente (vërtetime) që vërtetojnë se janë shlyer detyrimet doganore.
- Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore merret me shqyrtimin të kërkesës dhe përgatitjen e Autorizimit në përputhje me Aneksin Nr.32.
  - Refuzimi i kërkesës bëhet në qoftë se:
    - Kërkesa është e pasaktë
    - Nuk ka efekte ekonomike përdorimi i autorizimit
    - Nuk mund të identifikohen mallrat në produktet kompesuese
    - Shoqëria ka detyrime të pashlyera ndaj Administratës Doganore
    - Nëse testi ekonomik, (i cili realizohet në rastet kur ka ankesa nga prodhuesit vendas apo mallrat ose shoqëria janë klasifikuar me risk) rezulton negativ
3. Autorizimi për regjimin e përpunimit aktiv miratohet nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm Teknik i Doganës, përveç rasteve kur kjo kompetencë është deleguar degëve doganore për procedurë të thjeshtuar.
4. Aktivizimi në sistem. Pasi autorizimi është miratuar aktivizohet në sistem nga Sektori i Procedurave në DPD.

### **Neni 3**

#### **Rinovim i autorizimit**

1. Kërkesa për përfitimin e Autorizimit të Përpunimit Aktiv për shoqëritë që e kanë përfituar përdorimin e këtij regjimi doganor ekonomik një ose më shumë herë dhe për të njëjtin lloj aktiviteti përpunues, përpilohet sipas aneksit 27 të Dispozitave Zbatuese dhe paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
2. Rinovimi i autorizimit të Përpunimit Aktiv lind si nevojë e përfundimit të afati të përdorimit të autorizimit të mëparshëm. Dokumentacioni i nevojshëm që i bashkëngjitet kërkesës në këto raste, duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme:
  - Kopje origjinale të dokumentacionit mbi autorizimin e mëparshëm që përbëhet nga raporti i zyrës mbikëqyrëse (të shoqëruar me proces-verbalet ose akt-kontrollet përkatëse) për:
    - sasinë, vlerën e miratuar dhe të realizuar.
    - verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit dhe normativave të harxhimit të lëndëve të para
    - evidentimin e mbetjeve teknologjike, skarciteteve dhe destinacionin doganor të tyre
    - në rastet kur autorizimi i përfituar nuk konsumohet, lëshohet një vërtetim nga doganieri i regjimeve më arsyet e mosfunksionimit të tij.
  - Kontrata porosie e shoqërisë me firmat e huaja për përpunimin e mallrave.
  - Dokument (vërtetim) që tregon se janë shlyer detyrimet doganore.
  - Në rastet kur parashikohet të ketë një ose disa operatore paraqitet marrëveshja apo marrëveshjet mes tyre dhe kërkuesit të autorizimit si dhe identiteti fiskal i operatorit, deklaratë e operatorit.

3. Më qëllim shmangien e ndërprerjes së aktivitetit të shoqërisë që kërkon rinovimin e autorizimit të Përpunimit Aktiv, kërkesa duhet të paraqitet, të paktën 15 ditë para nga data e përfundimit të Autorizimit ekzistues
4. Në rastet kur, gjatë kohëzgjatjes së Autorizimit për Përpunim Aktiv, lind nevoja e ndryshimeve ose shtesave të mundshme si rrjedhojë e ndryshimeve kontraktuale pjesërisht ose tërësisht; si dhe në rastet kur lind nevoja e ndryshimit të përmbajtjes së një ose disa pikave të Autorizimit për shkak të ndryshimit të rrethanave që kushtëzojnë funksionimin e aktivitetit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave paraqitet një kërkesë me shkrim në të cilën përshkruhen të gjitha argumentimet e nevojshme që justifikojnë ndryshimet apo shtesat.
5. Kërkesës së sipërpërmendur, në varësi të rastit, i bashkëngjitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm si: kopje të Autorizimit ekzistues dhe shtese kontratë apo kontrata e re nëse është e nevojshme.

#### **Neni 4** **Procedura e thjeshtëzuar**

1. Proçedurat e thjeshtuara të autorizimit mund të përdoret në këto raste:
  - Operacionet që kanë të bëjnë me mallrat e një natyre jo-tregtare;
  - Riparime të produkteve kompesuese, përfshi edhe kontrollet e imta dhe rregullimet
  - Operacionet përpunuese të kryera në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë.
  - Riparimin e mallrave, përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre.
2. Në secilin nga rastet e pikës 4.1 deklarata për hyrjen nën këtë regjim (duke përdorur dokumentin DAV) do të përbëjë edhe kërkesën për autorizim dhe pranimin e autorizimit.
3. Dokumenti DAV bashkë me detajet e specifikuar në nenin 284 (3) të Dispozitave Zbatuese do të dorëzohet pranë zyrës doganore që është sugjeruar për vendosjen e mallrave në këtë regjim.

#### **Neni 5** **Futja e mallrave në regjim e përpunimit aktiv**

1. Futja në regjimin e përpunimit aktiv nënkupton procedurën e importimit të përkohshëm të mallrave për përpunim të cilat janë autorizuar.

Deklarimet për futjen në regjim:

- Në rastin e pezullimit DAV do të plotësohet : Kutia 1 IM5
- Në rastin e rimbursimit DAV do të plotësohet : Kutia 1 IM4

Futja në regjim behet vetëm në degët doganore të cilat janë aprovuar në autorizim.

2. Kodet e kutisë 37 të DAV janë më 4 shifra. Dy shifrat e para tregojnë procedurën e kërkuar dhe bazohen tek kodet e nëndarjes së dytë të kutisë 1 të deklaratës.

2.1 Dy shifrat e para të kodeve që përdoren në kutinë 37 janë:

- 51 mallrat e vendosura në sistemin me pezullim të Përpunimit Aktiv.
- 41 mallrat e vendosura në sistemin me rimbursim të Përpunimit Aktiv.

- 57 futja e mallrave në sistemin me pezullim të Përpunimit Aktiv në një ambient të magazinës doganore.
- 58 futja e mallrave në sistemin me pezullim të Përpunimit Aktiv në një ambient të magazinës se lire ose zones se lire.

2.2 Dy shifrat e dyta janë vijimi i dy të parave që përmendëm më sipër dhe tregojnë regjimin e mëparshëm doganor. Prandaj, nëndarja e majtë e kutisë 37 do të ketë 4 shifra me kombinime të ndryshme, disa prej të cilave po i paraqesim më poshtë:

- 5100 – Futja e mallrave në regjim për sistemin me pezullim të përpunimit aktiv pa pasur një regjim të mëparshëm doganor;
- 5151 – Transferimi i mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv me pezullim nga një autorizim tek tjetri;
- 4100 – Futja e mallrave në regjim për sistemin me rimbursim të përpunimit aktiv pa pasur një regjim të mëparshëm doganor ;
- 4141 – Transferimi i regjimit të përpunimit aktiv me rimbursim nga një autorizim tek tjetri;
- 5700 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në një ambient të magazinës doganore
- 5800 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në një ambient të magazinës se lire ose zones se lire.
- 5171 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv si vazhdimi i regjimit të magazinimit doganor;
- 4171 – Futja e mallrave në sistemin me rimbursim të përpunimit aktiv si një vazhdim i regjimit të magazinimit doganor;
- 5771 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë doganore si një vazhdim i regjimit të magazinimit doganor;
- 5178 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv duke ardhur nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë;
- 4178 – Futja e mallrave për sistemin me rimbursim të përpunimit aktiv duke ardhur nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë;
- 5778 – Futja e mallrave për sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë doganore, duke ardhur nga një zonë e lirë ose nga një magazinë e lirë;
- 5878 – Futja e mallrave në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë te lire ose zone te lire te ardhura nga ambientet e tyre.

## **Neni 6**

### **Mbikëqyrja doganore dhe kontrolli i regjimit**

1. Mbikëqyrje doganore e regjimit konsiderohet tërësia e rregullave të detyrueshme për zbatim dhe që mundësojnë mbajtjen në kontroll të zbatueshmërisë së kritereve të regjimit të përcaktuar në autorizim.  
Mbikëqyrja dhe kontrolli i regjimit behet nga sektori i regjimeve të zyrës doganore mbikëqyrëse të përcaktuar në formularin e autorizimit, ose në ato zyra doganore ku nuk ka sektor regjimesh, nga doganieret e regjimeve.
2. Detyrimet e shoqërisë ndaj degës doganore mbikëqyrëse;
  - Të depozitohë një deklaratë sipas modelit 1 (të këtij udhëzimi) të noterizuar

- Të depozitohet një kopje të autorizimit të aprovuar para se të ketë kryer veprime doganore;
  - Të sekretojë një regjistër të përshtatshëm për pasqyrimin e veprimeve të përpunimit aktiv për qëllime doganore, para se të ketë kryer çdo lloj veprimi;
  - Të depozitohet zyrtarisht një kopje të çdo DAV të shoqëruar me faturat përkatëse dhe regjistrin e importit apo eksportit sipas model 5 të këtij udhëzimi, të cilët mbahen në rrjedhë kronologjike për çdo artikull.
  - Të depozitohet bashkëlidhur çdo praktike eksporti, formularin që pasqyron detyrimin doganor të paguar (sipas model 6), për mallrat e importuara jo-origjinuese nga të cilat janë përfituar produktet kompensuese që rieksporthet n.q.s ato në bazë të rregullave të origjinës pajisen me certifikatën EUR 1. Ky formular është i bashkëlidhur me deklaratën doganore të eksportit.
  - Të depozitohet një deklaratë sipas modelit 2, të këtij udhëzimi, në lidhje me operatorët, ku konfirmohet se operatori pranon pa asnjë kusht kontrollin doganor në çdo kohe;
  - Të ketë të pasqyruar në mënyrë korrekte në librat e shoqërisë sasinë e mallrave të cilat janë shpërndarë operatorëve për përpunim;
  - Të pranojë kontrollin doganor në çdo moment kur paraqitet;
  - Të krijojë të gjitha mundësitë dokumentare dhe fizike për kontroll doganor.
3. Pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së autorizimit, përfshi këtu edhe kohën e përpunimit të cilësuar në pikën 8 të autorizimit, shoqëria është e detyruar të dorëzojë pranë degës së doganës mbikëqyrëse materialin e mbylljes së autorizimit sipas modelit 3 të këtij udhëzimi. Megjithatë kjo kohë do të jetë më e shpejtë në rastet kur i jepet destinacion doganor produkteve kompensuese. Koha e dorëzimit nuk mund të kalojë 30 ditë nga rastet e sipër përmendura, në të kundërt shoqëria penalizohet sipas nenit 272 të Kodit Doganor.
4. Kontrolli e regjimit mund të jetë dokumentar ose fizik.
- 4.1 Kontrollat dokumentare do të kryhen duke rakorduar për çdo rast hyrjet e mallrave në regjim me produktet kompensuese të përfutuara. Sipas deklaratave doganore, regjistrin të përpunimit aktiv dhe faturave të importit/eksportit si dhe duke hartuar një bilanc tremujor në formën e akt-rakordimit vetëm nën të njëjtin autorizim ndërmjet doganierit të regjimeve dhe përfaqësuesit të shoqërisë.
- 4.2 Kontrollat fizike përfshijnë kontrollin e detyrueshëm të:
- koeficientit të shfrytëzimit;
  - kontrollin fizik të mallrave të deklaruar në deklaratën e mbylljes së regjimit (për sistemin me pezullim) dhe kërkesën për rimbursim (për sistemin me rimbursim );
  - shkatërrimet e kryera nën kontrollin doganor ose të komunikuar nga kompania në rastet e forcave madhore; dhe
  - kryerja e kontrolleve të stokut, mbështetur në analizën e profileve të riskut, në ambientet e shoqërisë.

Këto kontrolle fizike mund të kryhen në mënyrë të papritur ose duke e njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e shoqërisë. Në përfundimin e kontrolleve fizike do të përgatiten raporte adekuatë (proces-verbal).

## Neni 7

### Përcaktimi dhe verifikimi i koeficientit të shfrytëzimit

1. Koeficienti i shfrytëzimit është sasia ose përqindja e produkteve kompensuese të përftuara nga përpunimi i një sasive të caktuar mallrash importi.
2. Për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit, duhen marre në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
  - sasia e produkteve kryesore kompensuese të prodhuara, d.m.th produktet për të cilat është aplikuar për përfitimin e regjimit të përpunimit aktiv.
  - sasia e produkteve dytësore kompensuese;
  - mallrat e humbura apo të konsumuara gjatë përpunimit (humbjet në prodhim), dhe
  - (nëse është rasti) sasia e aksesoreve dhe materialeve ndihmëse të prodhimit të përdorur për përftimin e mallrave të përpunimit aktiv, sipas aneksit 38 të Dispozitave Zbatuese.
3. Nëse përdoren shumë mallra të ndryshme importi për përftimin e një produkti të vetëm, atëherë koeficienti i shfrytëzimit shprehet si numri i secilit artikull importi që gjendet në një produkt që rieksporthet.
4. Nëse merret një artikull importi dhe ndahet në disa produkte të ndryshme, koeficienti i shfrytëzimit shprehet si sasia e artikullit të importit që prodhon një masë të caktuar në secilin produkt kompensues.
5. Në Aneksin 39 të Dispozitave Zbatuese jepen disa koeficiente shfrytëzimi standard për mallrat bujqësore
6. Koeficientët e shfrytëzimit, në rastet kur aplikohet për here të pare, deklarohet si i llogaritur nga aplikanti. Zyra doganore mbikëqyrëse pasi verifikon gjatë procesit të prodhimit koeficientin e miratuar dhe e gjen të ndryshëm me atë të kërkuar dhe të miratuar njofton menjëherë Sektorin e Procedurave për të reflektuar ndryshimin në Autorizimin përkatës. Në rastet kur kërkohet rinovim i Autorizimit për të njëjtën kategori mallrash dhe përpunimi koeficienti i deklaruar bazohet në verifikimet e zyrës mbikëqyrëse gjatë periudhës së Autorizimit paraardhës.
7. Ky koeficient shfrytëzimi do të verifikohet nga doganieret përgjegjës për regjimet pranë zyrës mbikëqyrëse.
8. Verifikimi i koeficientit të shfrytëzimit përfshin:
  - paraqitja dhe ekzaminimi i mostrave sipas kartave teknologjike;
  - shqyrtimi i kushteve të kontratës me furnitorët dhe klientët e shoqërisë;
  - vëzhgim praktik i proceseve të përpunimit;
  - peshimi ose matja e produkteve kompensuese kryesore dhe dytësore të përftuara nga përpunimi;
  - zbulimi i humbjeve gjatë prodhimit;
  - përcaktimi i materialeve ndihmëse në procesin e prodhimit sipas Aneksit 38 ; dhe
  - evidentimi i sasive të mallrave të importit, aksesoreve të prodhimit, produkteve kompensuese kryesore dhe dytësore në librat e përpunimit aktiv të tregtarit si dhe në dokumente të tjera që lidhen me regjimin;



- Në veçanti, proceset komplekse të përpunimit mund të kërkojnë që përcaktimi i koeficientit të shfrytëzimit të behet me kontroll *a-posteriori*;

### **Neni 8** **Zbatimin e afatit për riekспортim**

1. Pika nr. 8 e formularit të autorizimit do të specifikoje afatin për futjen, përpunimin, përgatitjen për riekспорт dhe daljen e produkteve kompensuese.
2. Në bazë të pikës 280.2 të Dispozitave Zbatuese, kjo periudhe mund të zgjatët nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pas një kërkesë të motivuar të mbajtësit të autorizimit.

### **Neni 9** **Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv**

1. Të gjitha mallrat të cilat janë futur në regjimin e përpunimit aktiv sipas kushteve dhe procedurave të sipër përmendura duhet që detyrimisht brenda afateve të autorizuar të dalin nga regjimi i përpunimit aktiv duke marrë një destinacion doganor.  
Mbajtësi i autorizimit është njëkohësisht edhe përgjegjës për caktimin e destinacionit doganor. Në rast të shkeljes së këtyre afateve aplikohen gjopa sipas nenit 272 të Kodit Doganor.
2. Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv nënkupton njërën nga procedurat e mëposhtme :

- Riekспортim;
- Shkatërrimi nën kontrollin doganor;
- Braktisja në favor të buxhetit të shtetit;
- Transferimi në autorizimin pasardhës ose transferimi nga një mbajtës i autorizimit të përpunimit aktiv tek një tjetër;
- Vendosja në regjimin e magazinimit doganor
- Hyrja në një zonë të lire apo magazinë të lire
- Çlirim për qarkullim të lire brenda vendit

- 2.1 Në rastin e riekспортit DAV do të plotësohet :  
Kutia 1 EX 3

Riekporti behet vetëm në degët doganore të cilat janë aprovuar në autorizim. Kombinimi i kodeve të kutisë 37 do të jetë :

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi:

- 3151 ri-eksportimi i mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv;
- 3141 ri-eksportimi i mallrave të vendosura në sistemin me rimbursim të përpunimit aktiv;

- 2.2 Asgjësimi/Humbje

Kutia 1 IM 9

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi

- 9351 asgjësimi i mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv;
- 9341 asgjësimi i mallrave të vendosura në sistemin me rimbursim të regjimit të përpunimit aktiv.
- 9951 humbje (firo) gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv;
- 9941 humbje (firo) gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura në sistemin me rimbursim të regjimit të përpunimit aktiv
- 9357 asgjësimi i mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë doganore;
- 9358 asgjësimi i mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.
- 9957 humbje (firo) gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë doganore.
- 9958 humbje (firo) gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

2.2.1 Kur produktet kompensuese dytësore nuk kanë vlerë përdorimi ju jepet destinacioni doganor i asgjësimit sipas procedurave të paraqitura në nenin 9 pika 2.2.

Deklarimi doganor do të shoqërohet me një fletë peshoreje ( në se shoqëria ka një të tillë ) ose me një deklaratë të shoqësisë për peshën e mallrave. Në se analiza e riskut përcakton kontroll fizik ky kontroll mund të bëhet edhe pranë ambjentëve të shoqërisë. Dega e doganës mbikqyrese ngarkon të paktën dy doganierë për kryerjen e procedurave të cilët pas asgjësimit mbajnë një procesverbal i cili i bashkëlidhet deklaratës pavarësisht çlirimit të saj. **(ndryshuar me udhëzim nr. 1/1, datë 29/01/2014).**

### 2.3 Hedhja në qarkullim të lirë

Kutia 1 IM 4

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi:

- 4051 lejimi për përdorim të brendshëm të mallrave më parë të vendosura në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv;
- 4041 lejimi për përdorim të brendshëm të mallrave më parë të vendosura në sistemin me rimbursim të përpunimit aktiv;
- 4057 lejimi për përdorim të brendshëm i mallrave më parë të vendosura në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në ambientin e një magazinë doganore;
- 4058 lejimi për përdorim të brendshëm i mallrave të vendosura më parë në sistemin me pezullim të përpunimit aktiv në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

2.3.1 Kur produktet kompensuese dytësore kanë vlerë, apo pas asgjësimit ngelet vlerë përdorimi dhe nuk rieksporthen detyrimisht do t'u caktohet destinacioni i vendosjes në qarkullim të lirë sipas procedurave të paraqitura në nenin 9 pika 2.3.

Deklarimi doganor do të shoqërohet me faturën në se këto mallra shiten, ku tregohet sasia dhe vlera e tyre. Në se do të vazhdojnë të ngelen pronë e saj do të shoqërohet me një deklaratë për vleresimin kontabël të tyre nga shoqëria.

Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore të këtyre produkteve do të bazoheni në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”. **(ndryshuar me udhëzim nr. 1/1, datë 29/01/2014).**

#### 2.4 Kalimi nga një autorizim tek një tjetër autorizim i përpunimit aktiv;

Kutia 1 IM 4 ose 5 në varësi të sistemit të autorizimit

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi

- 5151 - Transferimi i mallrave apo produkteve kompesuese të një regjimi të përpunimit aktiv më pezullim tek një tjetër;
- 4141 - Transferimi i mallrave apo produkteve kompesuese të regjimi të përpunimit aktiv më rimbursim tek një tjetër;

#### 2.5 Vendosja në regjimin e magazinimit doganor

Kutia 1 IM 7

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi:

- 7151 - Vendosja në regjimin e magazinimit doganor të mallrave, më parë të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv.
- 7141 - Vendosja në regjimin e magazinimit doganor të mallrave, më parë të vendosura në sistemin me rimbursim të regjimit të përpunimit aktiv.

#### 2.6 Hyrja në një zonë të lirë apo magazinë të lirë

Kutia 1 IM 7

Kutia 37 Nënndarja e majtë – Kodi

- 7851 - Vendosja në një zonë të lirë ose magazinë të lirë të mallrave, më parë të vendosura në sistemin me pezullim të regjimit të përpunimit aktiv.
- 7841 - Vendosja në një zonë të lirë ose magazinë të lirë të mallrave, më parë të vendosura në sistemin më rimbursim të regjimit të përpunimit aktiv.

### Neni 10

#### Transferimi i mallrave nga një autorizim te një autorizim tjetër

1. Në rastet kur një pjesë e mallrave apo aksesorëve të futura në një autorizim trupëzohen në produktet kompesuese të autorizimit të mëposhëm, mallrat apo produktet kompesuese nga autorizimi i përpunimit aktiv të parë mund të kalojnë në autorizimin e përpunimit aktiv pasues me kusht që mbajtësi i autorizimit të jetë i njëjtë. Në këtë rast transferimi i mallrave apo produkteve kompesuese kryhet me leje të degës doganore mbikëqyrëse. Për çdo transferim bëhet vetëm një deklaratë doganore ku në kutinë 37 të DAV vendoset kodi i procedurës 5151 ose 4141. Deklarata doganore do të lidhet me autorizimin në të cilin do të hyjnë mallrat, por në deklaratë në kutinë 44 do të shenohet dhe numri i autorizimit nga i cili kanë dale mallrat (sipas shembullit bashkëlidhur udhëzimit).

2. Mallra në gjendje të pandryshuara apo produkteve kompesuese, mund të transferohen nga një mbajtës në një mbajtës tjetër autorizimi të përpunimit aktiv. Përgjegjësia për mallrat ose produktet e transferuara i kalon mbajtësit të autorizimit të dytë në kohën në të cilën ai merr në dorëzim mallrat ose produktet në fjalë. Transferimi kryhet me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Për çdo transferim bëhet një deklaratë doganore ku në kutinë 37 të DAV vendoset kodi i procedurës 5151 ose 4141. Deklarata doganore do të lidhet me autorizimin në të cilin do të hyjnë mallrat, por në deklarate në kutinë 44 do të shenohet dhe numri i autorizimit nga i cili kanë dale mallrat (sipas shembullit bashkëlidhur udhëzimit).

## **Neni 11**

### **Disa nocione në lidhje më funksionimin e regjimit**

1. Çdo sasi mallrash për përpunim në momentin kur hyjnë në territorin doganor përkundrejt autorizimit i nënshtrohen pezullimit të detyrimeve doganore (borxhit doganor), pavarësisht se autorizimi jepet për një sasi vjetore mallrash për përpunim, çdo njeri prej tyre apo çdo sasi e importuar duhet detyrimisht të respektoje më vetë kushtet e përcaktuara në autorizim.

2. Referuar nenit 136.2.c të Kodit Doganor në këtë regjim mund të futën edhe mallra të cilat nuk gjenden në produktet kompesuese, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve, edhe sikur ato të jenë përdorur tërësisht ose pjesërisht gjatë procesit të punës. Të tilla do të konsiderohen të gjitha ato mallra që shërbejnë si katalizatore ndihmës në procesin e prodhimit, apo ingredientë të rëndësishëm në procesin e prodhimit nëpërmjet të cilëve mallrave ju ndryshohet forma natyra apo cilësia, në këtë grupim nuk mund të futët lënda djegëse, energjia elektrike, apo materiale të tjera që i bashkëngjiten teknologjisë e cila përdoret për kryerjen e operacioneve të përpunimit në këtë regjim.

3. Në këtë regjim hyjnë gjithashtu edhe ato mallra të cilët kthehen në gjendje të pandryshuar por që kontribuojnë në pamjen, rritjen e cilësisë dhe plotësimin e kërkesave të marketingut të produkteve kompesuese parësore.

4. Pika 8 e autorizimit përfshin gjithashtu veç kohës se nevojshme për përpunim edhe kohën kur mallrat rrinë të magazinuara për tu përshtatur më konjunkturën e tregut si dhe më kërkesat e porositësit apo kontraktorit. Sipas pikës 280.2 të Dispozitave Zbatuese, në raste të veçanta ky afat mund të shtyhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave më një kërkesë të motivuar të mbajtësit të autorizimit.

5. Në rastet kur mallrat e futura në regjim apo produktet kompesuese parësore marrin destinacion doganor vendosje në qarkullim të lire aplikohet interes kompesues. Interesi kompesues do të vendoset sipas kushteve të përcaktuara në pikën 295 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor. Metodatat e thjeshtëzuara për llogaritjen dhe kontabilizimin e interesit kompesues mund të përdoren më kërkesën e personave të interesuar.

## **Neni 12**

### **Bilanci material dhe faturimi**

1. Gjatë përpunimit në produktet kompesuese parësore dhe dytësore mund të trupëzohen edhe mallra shqiptare në varësi të proceseve që kryhen apo dhe interesave ekonomike të prodhuesit. Gjithashtu këtyre produkteve ju rritët vlera për shkak të transformimit ku përfshihen puna, energjia, konsumi i teknologjisë fitimi i operatorit ekonomik etj.

2. Për të mundësuar një mbikëqyrje sa më të saktë dhe transparentë të regjimit si dhe për të pasur një efekt ekonomik të matshëm operatori ekonomik në të gjitha rastet e rieksporimit duhet të paraqitet fatura më këto elementë:

- Artikujt jo shqiptare që rieksporthen
- Lloji
- Sasia
- Peshë neto ( përfshin dhe ambalazhet kur janë mallra të importuara nën regjim)
- Peshën bruto
- Vlera e produkteve kompesuese që rieksporthet
- Vlera e Shtuar (duke përfshirë edhe koston e mallrave shqiptare)
- Peshë e mallrave shqiptare të trupëzuara

Kjo faturë është e detyrueshme për qëllime doganore së bashku me regjistrat e importit dhe eksportit për mbikëqyrjen e regjimit.

### Neni 13

#### Plotësimi i deklaratës së ri-eksportit

Plotësimi i deklaratës së *ri-eksportit* do të kryhet si më poshtë:

1. Nëse pronar i mallrave jo shqiptare është një shoqëri e huaj, të gjitha operacionet e përpunimit bëhen për llogari të saj dhe të gjitha produkteve kompesuese parësore i jepet destinacion rieksporimi drejt saj apo klientëve të saj:
  - Në kutinë 22 të DAV vendoset - *vlera e faturuar* (vlera e punës + vlera e mallrave shqiptare);
  - Kutia 44 e DAV, transporti i brendshëm vendoset – *vlera e mallrave të importuar* që është trupëzuar në produktin kompesues që po eksportohet (vetëm vlera e mallrave të importuar);
  - Kutia 35 e DAV - peshë bruto;
  - Kutia 38 e DAV, peshë neto - *Peshë neto* do të përfshijë: peshën e produktit kompesues (peshën e lëndëve të para të importuara + peshën e mallrave shqiptare të trupëzuara në këto produkte kompesuese) + peshën e ambalazheve nëse këto ambalazhe janë importuar;
2. Nëse pronar i mallrave jo shqiptare është një shoqëri shqiptare e cila kryen operacionet e përpunimit për llogarinë e vet dhe i rieksporin produktet kompesuese parësore drejt klientëve të saj të kontraktuar:
  - Në kutinë 22 të DAV vendoset - *vlera e faturuar* (vlera e punës + vlera e mallrave shqiptare + vlera e mallrave të importuar);
